**VENDIM**
**Nr. 569, datë 3.9.2014**

# PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË, MBI AKTIVITETIN FITIMPRURËS TË PERSONAVE TË VARUR TË ANËTARËVE TË MISIONEVE DIPLOMATIKE DHE ZYRAVE KONSULLORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, mbi aktivitetin fitimprurës të personave të varur të anëtarëve të misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

## MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË, MBI AKTIVITETIN FITIMPRURËS TË PERSONAVE TË VARUR TË ANËTARËVE TË MISIONEVE DIPLOMATIKE DHE ZYRAVE KONSULLORE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Sllovenisë,

*me dëshirën* për të lidhur një marrëveshje, me synim lehtësimin e aktivitetit fitimprurës të personave të varur të anëtarëve të misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore të shtetit dërgues në territorin e shtetit pritës,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Të dy qeveritë pranojnë që, mbi bazën e reciprocitetit për personat e varur të punonjësve të akredituar të shtetit dërgues të caktuar me detyrë zyrtare në shtetin pritës si anëtarë të misioneve diplomatike ose të një zyre konsullore, të marrin autorizim për të filluar aktivitet fitimprurës në shtetin pritës.

Neni 2

1. Anëtar i një misioni diplomatik ose zyre konsullore është një punonjës i shtetit dërgues i cili nuk është shtetas i shtetit pritës dhe i cili është caktuar me detyrë zyrtare në shtetin pritës në një mision diplomatik, zyrë konsullore ose mision në një organizatë ndërkombëtare.

2. Persona të varur janë:

a) bashkëshortët ose partnerët sipas ligjit;

b) fëmijët e pamartuar të varur të punonjësve deri në 18 ose 26 vjeç nëse ndjekin me kohë të plotë si student një institucion arsimor pas shkollës së mesme; dhe

c) fëmijët e pamartuar të varur të punonjësve të cilët janë me aftësi të kufizuar, fizike ose mendore.

Neni 3

1. Asnjë kufizim nuk mund të vendoset mbi tipin e aktivitetit fitimprurës që mund të fillohet. Megjithatë, në profesionet ku kërkohen kualifikime të caktuara, do të jetë e nevojshme që personi i varur të përmbushë këto kualifikime.

2. Autorizimi për të filluar një aktivitet fitimprurës mund të refuzohet, në rastet kur, për shkaqe të sigurisë, mund të punësohen vetëm shtetas të shtetit pritës.

3. Çdo leje për të filluar një aktivitet fitimprurës në shtetin pritës mbaron me përfundimin e emërimit të punonjësit.

Neni 4

1. Para se një person i varur mund të fillojë një aktivitet fitimprurës në shtetin pritës, misioni diplomatik i shtetit dërgues i bën një kërkesë zyrtare sektorit të protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të shtetit pritës.

2. Pas verifikimit që personi në fjalë përfshihet brenda kategorive të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe pas respektimit të procedurave të brendshme të zbatueshme, sektori i protokollit njofton menjëherë dhe zyrtarisht misionin diplomatik që personi ka leje për të filluar aktivitet fitimprurës pas përmbushjes së kërkesave ligjore në pajtim me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në shtetin pritës, duke lëshuar, sipas rastit, lejen e punës.

Neni 5

1. Për personat e varur, të cilët fillojnë aktivitet fitimprurës sipas kësaj Marrëveshjeje dhe të cilët kanë imunitet nga juridiksioni i shtetit pritës në pajtim me Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike ose Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore, shteti dërgues heq dorë në mënyrë të parevokueshme nga imuniteti, nga juridiksioni civil dhe administrativ në lidhje me të gjitha çështjet qe rrjedhin nga ky aktivitet fitimprurës.

2. Në rast se një person i varur, i cili ka imunitet nga juridiksioni penal në pajtim me Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike ose Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore, akuzohet për një vepër penale të kryer në lidhje me aktivitetin e tij ose të saj fitimprurës, shteti dërgues shqyrton me kujdes çdo kërkesë me shkrim që mund të paraqitet nga shteti pritës për heqjen dorë nga ky imunitet.

Neni 6

Personat e varur që fillojnë aktivitet fitimprurës sipas kësaj Marrëveshjeje u nënshtrohen regjimeve fiskale dhe të sigurimeve shoqërore të shtetit pritës për të gjitha çështjet në lidhje me aktivitetin e tyre fitimprurës në atë shtet.

Neni 7

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit nëpërmjet kanaleve diplomatike, që të gjitha kërkesat e nevojshme të brendshme ligjore për hyrjen e saj në fuqi janë përmbushur.

Neni 8

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila palë mund ta prishë këtë në çdo kohë duke bërë një njoftim me afat gjashtëmujor me shkrim drejtuar palës tjetër.

Bërë në Lubjanë, më 16 qershor 2014, në dy kopje, në gjuhën shqipe, sllovene dhe angleze, ku të tre tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze

do të ketë përparësi.